



TOYOTA PAISJE PËR PASTRIM



PASTRUES MOTORI ORIGINAL TOYOTA

TOYOTA GENIUNE ENGINE FLUSH (TGEF)

Paisje origjinale për pastrim

Ruan performancën më të mirë të motorit. Edhe vajrat modern sintetike nuk mund të pastrojnë të gjitha papastërtitë dhe grimcat të cilat mbledhën në motor gjatë funksionimit të tij normal. Nëse lejoni që në motor të mbledhën depozitat me kalimin e kohës kjo mund të ndikoj në qarkullimin e vajit dhe të çojë në konsum të pjesëve vitale të motorit.

Pasojat e formimit të depozitave të vajit në motor:



Shkaktarët kryesor që ndikojnë në formimin e depozitave në motor:

- Ndërrimi i parregullt i vajit të motorit
- Vozitje të shpeshta e të shkurta
- Punë e shpeshtë në ler gaz
- Vozitjet e shpeshta të ndalimit dhe ngasjes
- Ngasja e shpeshtë jashtë rrugës
- Cilësi e dobët e karburantit

Disa shprehi të vozitjes mund t'i përshpejtojnë këto fenomene, ndaj pastrimi i motorit nga depozitat, para se të kthehen në llum, është i rëndësishëm për shëndetin e veturës suaj.

PËRPARËSITË E PËRDORIMIT TË TGEF

I thjeshtë për përdorim

TGEF eliminon deri në 85% të depozitave në motor duke i pastruar ato së bashku me vajin e mbetur në procesin e ndërrimit të rregullt të vajit të motorit.



Para



Pas


TGEF fuqishëm pastron motorin dhe është i sigurt për t'u përdorur, pa tretës dhe i lehtë për t'u përdorur me të gjitha llojet e vajrave të motorit.

Përfitimet kryesore të përdorimit të TGEF:

- Rrit fuqinë e motorit
- Rrit jetëgjatësinë e motorit
- Zvogëlon konsumin e karburantit
- I sigurt për t'u përdorur
- nuk dëmton pjesët e motorit
- Shpejtë

INFORMACION I DOBISHËM

Aplikimi është i thjeshtë dhe kryhet gjatë ndërrimit të rregullt të vajit të motorit. Lehtë, Sigurtë, Shpejtë



Pastrimi i motorit me TGEF rekomandohet në çdo servis të rregullt, veçanërisht për ndërrime të parregullta të vajit të motorit, vozitje në distanca të shkurtra, vozitje jashtë rrugës dhe vozitje të shpeshta me ngarkesë të madhe.

TOYOTA PASTRUES I SISTEMIT TË KARBURANTIT

FUEL INJECTOR CLEANER (FIC)

Shijoni një udhëtim më të pastër, më të rehatshëm dhe ekonomik

Motorët Toyota janë krijuar për të ofruar performancë të jashtëzakonshme dhe këtë e arrijnë më së miri kur janë të pastër. Për shkak se punojnë në temperatura të larta dhe tolerancave jashtëzakonisht të vogla, madje mbledhje e sasive të vogla të depozitave dhe papastërtive mund të ndikojnë në funksionimin e motorit.

Me kalimin e kohës, depozitat grumbullohen në mënyrë të pashmangshme brenda motorit dhe në sistemet e injektimit të karburantit dhe mund të çojnë në përkeqësim të ndezjes, trokitje të motorit fuqi më të dobët, si dhe në rritjen e konsumit të karburantit.

Arritni konsumin e humbur (optimal) të karburantit duke përdorur një pastrues injektorësh Toyota.

Një trajtim për pastrimin e sistemit të injektimit të karburantit është e mjaftueshme për të kthyer ekonominë e karburantit dhe performancës. Pastruesi i injektorit largon depozitat nga pjesët kryesore brenda motorit dhe sistemit të injektimit të karburantit, duke ndihmuar në reduktimin e emetimeve të gazërave, kthimin e fuqisë së humbur dhe zgjatje të jetëgjatësisë së injektorit.

Si funksionon një pastrues i injektorëve Toyota?

Pastruesi i injektorëve të Toyota-s fillon të punojë menjëherë dhe tërësisht pastron të gjithë sistemin e injektimit të karburantit dhe dhomën e djegies në motor. Pastron pjesën e mbrendshme të injektorit të karburantit dhe rreth injektorit, përmirëson formën e spërkatjës së karburantit dhe efikasitetit të djegies.

Në rastin e motorëve me benzinë hiqet shtresë nga depozitat e djegura në valvulat thithëse që përndryshe do të kufizojnë rrjedhën e karburantit dhe ajrit në cilindra. Një trajtim me pastrues injektorësh Toyota, do të afrojë nivelin e emetimeve të gazërave në vlerat e përcaktuara gjatë prodhimit të automjetit.

TOYOTA PASTRUES I SISTEMIT TË KARBURANTIT TEK MOTORET BENZINE

Ky pastrues në bazë detergjenti është testuar gjerësisht për të ofruar efikasitet të jashtëzakonshëm. Pastron kandelat, përmirëson performancën e motorit gjatë vozitjes (ndezja) dhe thellësisht pastron dhomat e djegies. Kjo sjell në një rritje të fuqisë, konsum më ekonomik dhe punë më të qetë të motorit.



Karakteristikat kryesore:

- Teknologji e avancuar pa hi
- I përshtatshëm për të gjitha pjesët e sistemit të injektimit të karburantit
- I sigurt për t'u përdorur me katalizatorë dhe sensorë oksigjeni.





1. PARA: Depozitat në valvolat thithëse mund të shkaktojnë ngjitje, mbyllje jo korrekte dhe kompresion të reduktuar të motorit.

2. PAS: Paraqitja pas trajtimit, valvola thithëse e pastruar funksionon siç duhet, ndihmon në kthimin e performances së humbur dhe konsum më ekonomik të karburantit.



Pastron depozitat brenda injektorëve të karburantit dhe rreth injektorëve, përmirësimi i formës së injektimit.



Pastron depozitat nga pistonët e motorit për djegie më të mirë.

TOYOTA PASTRUES I SISTEMIT TË KARBURANTIT TEK MOTORET DIESEL

Pastruesi është projektuar për pastrim të thellë si dhe pastrimin e të gjithë sistemit për injektim të karburantit. Pastruesi është detajisht i testuar për arritje superiore të performancës dhe eliminimin e depozitave për të reduktuar konsumin e karburantit dhe të siguroj punë pa pengesa të motorit.



Karakteristikat kryesore:

- Teknologji e avancuar pa hi
- Ndhomon në heqjen e depozitave të karbonit nga lart dhe brenda injektorit të naftës
- Përmirëson vlerën e djegies optimizon djegien
- I përshtatshëm për motorët diesel me injektim direct dhe indirekte, me common rail dhe turbo.
- I përshtatshëm për të gjitha pjesët e sistemit të injektimit të karburantit

PARA



PAS

